



KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT

Tiranë më, 02.05.2025

HISTORI SUKSESI

KSHH kontribuon me sukses në garantimin e lirisë së medias dhe të shtypit, lirisë personale dhe mbrojtjen nga diskriminimi, në përfaqësimin e gazetarit P.GJ nga diskriminimi i ushtruar prej Drejtorisë Vendore të Policisë Lezhë

Histori suksesti-KShH kontribuon me sukses në garantimin e lirisë së medias dhe shtypit, lirisë personale dhe mbrojtjen nga diskriminimi nëpërmjet përfaqësimit të gazetarit me inicialet P.GJ ndaluar në mënyrë të paligjshme gjatë ushtrimit të detyrës, prej Drejtorisë Vendore të Policisë Lezhë.

Puna e gazetarëve në Shqipëri mbetet gjithmonë sfiduese. KShH ka monitoruar në mënyrë vijuese respektimin e të drejtave të tyre në punë dhe i ka asistuar ligjërisht duke i përfaqësuar përpara instiucioneve shtetërore dhe Gjykatave të niveleve të ndryshme duke synuar fuqizimin e rolit dhe pozitave të tyre.

Liria e shprehjes, e sanksionuar nga paragrafi 1 i nenit 10 të Konventës Europiane të të Drejtave të Njeriut, përbën një nga themelet e një shoqërie demokratike, një nga kushtet parësore të përparimit të saj. (*Vendimi i GjEDNj Lingens k. Autrisë*).

Në datën 11.04.2021, gazetari P.Gj ka qenë duke ushtruar detyrën e tij si gazetar duke raportuar live në televizion ecurinë e protestës që po zhvillohej nga banorët e Njësisë Administrative Fan, pranë Tunelit të Kalimashit.

Pas përfundimit të protestës gazetari P.Gj u shoqërua nga Policia në ambjentet e Komisarariatit të Lezhës me motivin e pjesëmarrjes në protestën e paligjshme të realizuar në fshatin Fan Mirditë. Shoqërimi i tij në komisarariat ka ndodhur pavarësisht se gazetari njihej nga punonjësit e policisë në zonë për detyrën që kryente. Mbi këtë ngjarje pati një reagim të fortë publik nga Unioni i Gazetarëve Shqiptarë dhe mediat e tjera duke u penguar në ushtrimin e detyrës së tij.

Pasi u njoh me rastin dhe mënyrën se si ai kishte ndodhur, pasi vlerësoi shkaqet ligjore dhe pasojat e veprimeve të Policisë së Lezhës, KShH vendosi ta përfaqësojë gazetarin duke u ankuar përpara Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

Komisioneri me Vendimin nr. 184, datë 14.09.2023 konstatoi se: “Drejtoria Vendore e Policisë Lezhë, me veprimet dhe mosveprimet e saj, ka diskriminuar ankuesin në të drejtën e tij për të ushtruar profesionin e gazetarit për të raportuar ngjarjet e zhvilluara pas protestës, në formën e diskriminimit ndërsektorial dhe të tërthortë, trajtim i cili ka ardhur si pasojë e identifikimit të tij si gazetar lokal që raporton për problematikave të zonës dhe se televizioni ku ai punonte kishte linjë editorial për evidentimin e problematikave në nivel lokal.”

Drejtoria Vendore e Policisë Lezhë ka kundërshtuar vendimin e mësipërm të KMD në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë. Me vendimin e datës 30.04.2025, Gjykata ka lënë në fuqi vendimin e Komisionerit duke e konsideruar vendim të drejtë dhe të marrë në përputhje me ligjin.

KShH e vlerëson vendimin e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi dhe vendimin e Gjykatës Administrative të Shkllës së Parë Tiranë si një hap shumë pozitiv në krijimin e një praktike të vlefshme për të luftuar format e sulmit ndaj gazetarëve dhe veçanërisht diskriminimin. KShH inkurajon edhe institucionet e tjera, veçanërisht institucionet e drejtësisë të marrin masa të shpejta dhe efektive për të adresuar të gjitha format dhe sulmet ndaj gazetarëve.